

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me numër fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20, dhe nenit 6, paragrafi 2 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 06.05.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Raporti i Përzgjedhjes së Logos së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.
2. Fitues i Konkursit është propozimi me kodin 0802.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

RAPORT I PËRZGJEDHJES SË LOGOS SË OIRK-SË

Në përputhje me Ligjin Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit të Bordit Drejtues nr. 10-Bd/2025, është shpallur konkursi publik për përzgjedhjen e logos zyrtare të OIRK-së. Konkursi ka qenë i hapur publikisht dhe për të gjithë të interesuarit, për periudhën e përcaktuar, dhe është bërë publik përmes: Rrjeteve sociale të OIRK-së, Faqes zyrtare të MMPHI-së, në rubrikën e ndarë për OIRK, si dhe në portalin www.kosovajob.com.

Pjesëmarrja në konkurs

Gjatë periudhës së aplikimit, janë pranuar **19 propozime të dizajnit për logon e OIRK-së** nga kandidatë të ndryshëm. Të gjitha propozimet janë shqyrtuar në mënyrë të barabartë dhe anonime.

Komisioni përzgjedhës

Me vendim të Bordit Drejtues është themeluar Komisioni për vlerësimin e propozimeve për logon, me këtë përbërje:

- **Afrim Demiri** – Kryesues
- **Arsim Rapuca** – Anëtar
- **Mimoza Shahini** – Anëtare

Procesi i vlerësimit

Komisioni është mbledhur në datën 29.04.2025 për të shqyrtuar të gjitha aplikimet, të cilat janë identifikuar vetëm përmes kodeve anonime. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Originaliteti dhe kreativiteti i logos
- Përshtatshmëria me fushën e inxhinierisë së ndërtimtarisë, elektrikës dhe makinerisë.
- Qartësia vizuale dhe përdorshmëria në formate të ndryshme
- Identifikueshmëria dhe përfaqësimi institucional

Pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve, **logoja me kodin 0802** është vlerësuar si më përfaqësuesja e identitetit të OIRK-së, duke përmbushur më së miri të gjitha kriteret e përmendura.

Rekomandimi

Komisioni i përzgjedhjes i rekomandon Bordit Drejtues të OIRK-së që të miratojë **logon me kodin 0802** si logo zyrtare të institucionit, dhe që kjo logo të përdoret në të gjitha dokumentet, komunikimet dhe materialet zyrtare të Odës.

Për Komisionin:

Afrim Demiri, Kryesues

Arsim Rapuca, Anëtar

Mimoza Shahini, Anëtare